

AKTI I THEMELIMIT
I
SHOQERISE TREGTARE ME PERGJEGJESI TE KUFIZUAR
“AIDA 24” sh.p.k

Themeluesit qe nenshkruan si me poshte jane si vijon:

Znj.Aida Zhupani, e datelindjes 12/08/1995, e bija Artanit, lindur ne Lushnje dhe banues ne Tiranë, identifikuar me pasaport nr.**BR6796556** dhe nr personal **J55812027R** madhor, me zotesi te plote juridike per te vepruar,

Qe ne vijim do te quhet Ortaku i Shoqerise “AIDA 24” sh.p.k

Sot me date **18.04.2024**, bazuar ne vullnetin e tij te lire dhe ne perputhje me ligjin Nr.9901 date 14.04.2008 “Per Tregtaret dhe Shoqerite Tregtare”, vendosi te themeloje Shoqerine Tregtare me Pergjegjesi te Kufizuar, ne baze te kushteve qe vijojne:

Kreu I
OBJEKTI, EMERTIMI, SELIA, REGJIMI JURIDIK

Neni 1

Objekti i shoqerise

Shoqeria Tregtare “**AIDA 24**” sh.p.k, ka si objekt veprimtarie:

Klinike dentare: sherbime te ndryshme dentare.

Neni 2

Emertimi dhe Selia Juridike e Shoqerise

Ortaku vendosi qe shoqerine ta emertojne “**AIDA 24**” sh.p.k

Selia juridike e Shoqerise ndodhet ne *Njësia Administrative nr.9, Rruga e "Dibrës" (Bajram Curri), pallati 405, shk.2, kati 2, ap.11, Tiranë.*

Shoqeria mund te krijojte qendra sekondare, filiale, zyra perfaqesimi e agjenci ne qytete te tjera te Shqiperise ose jashte vendit.

Neni 3

Forma Juridike

1. Shoqeria eshte shoqeri me pergjegjesi te kufizuar. Veprimtaria e saj i nenshtrohet dispozitave te Aktit te Themelimit, Statutit dhe legjislacionit shqiptar ne fuqi
2. Me vendim te ortakeve mund te ndryshoje formen juridike te Shoqerise, ne qofte se ne te ardhmen krijohen premisa me te favorshme per funksionimin e saj sipas legjislacionit shqiptar.

3. Ne kete rast ortaku do ta pershtasi Aktin e Themelimit dhe Statutin e shoqerise, si dhe do te bejne regjistrimin e saj ne rregjistrin tregtar, ne organet kompetente shqiptare.
4. Shoqeria gezon personalitet juridik nga data e regjistrimit te saj ne regjistrin tregtar nga organet kompetente dhe ne perputhje me ligjin.
5. Shoqeria do te kete vulen e saj.

Kreu II

TE DREJTAT DHE DETYRAT, KOHEZGJATJA

Neni 4

Te drejtat e Shoqerise dhe te Ortakut

1. Shoqeria ka te drejte te lidhe marreveshje dhe te nenshkruaje kontrata ne territorin e Shqiperise dhe jashte saj.
2. Shoqeria gezon te drejten te krijojë pasuri materiale dhe intelektuale.
3. Shoqeria ka te drejte te marre pjese si ortak ne nje shoqeri tjeter ose ndermarrje te ndryshme ne Shqiperi ose jashte saj, ne perputhje me legjislacionin shqiptar.
4. Shoqeria pergjigjet ndaj te treteve vetem dhe ekskluzivisht me kapitalin e saj shoqeror te derdhur dhe me te mirat e pasurise se saj.
5. Ortaket merrin pjese ne administrimin e veprimtarise se shoqerise ne perputhje me Aktin e Themelimit dhe Statutin, vet ose nepermjet perfaqesuesve te tij.
6. Ortaket kan te drejte te marrin te gjitha informatat qe kane te bejne me veprimtarine prodhuese, projektuese, realizuese e tregtare te shoqerise, si bilancet, llogarite ekonomike etj.

Neni 5

Kohezgjatja

Kohezgjatja e shoqerise eshte me afat te pacaktuar.

Kreu III

KAPITALI THEMELTAR

Neni 6

Kapitali Themeltar

Kapitali themeltar eshte **100,000 (njqindmije) Leke**. 1 (nje) kuote gjithsej.

Ortaku i shoqerise eshte:

1. **Aida Zhupani**, zotëruesi i 1 (nje) kuote me vlere 100,000.00 lek, qe perfaqeson **100% (njqinde %)** kapitalin themeltar të shoqërisë;

Kreu IV

PERSONALITETI JURIDIK

Neni 7

Shoqeria fiton personalitetin juridik ne ditën e regjistrimit te saj ne Rregjistrin Tregtar ne Qendren Kombetare te Biznesit, si dhe fillon veprimtarine e saj me marrjen e licences te ushtrimit se veprimtarise.

Kreu V ADMINISTRIMI

Neni 8

Shoqeria do te administrohet nga administratori **Aida Zhupani** i cili perfaqeson shoqerine ne marredheniet me te tretet per nje periudhe **5 (pese)** vjecare dhe me te drejte rizgjedhje.

Administratori mund t'i delegeje kompetencat e saj me shkrim ne formen e autorizimit ose me prokure.

Kreu VI DISPOZITA TE TJERA

Neni 9

Fitimi i realizuar nga Shoqeria, pas shlyerjes se detyrimeve ligjore, do t'i mbetet Ortakut te saj, ta ndaje si dividend apo ta shtoje ne kapitalin e shoqerise.

Ky Akt shtypet dhe nenshkruset ne 2 (dy) kopje, te gjitha me te njejten vlere ligjore.

Nje kopje qendron ne dokumentacionin baze te shoqerise.

Ortaku Themelues

Aida Zhupani

